



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-260

07.09.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i zbardhur) (Nr. ynë ark.01-3732/1) datë 29.7.2019., Vendim PA1 nr.08-260 datë 30.08.2023 për heqjen e lejes së radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.06.2016 dhe Konkluzionin me nr. ark.02-3375/3 datë 06.09.2023, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të mbajtur më 06.09.2023, miratoi

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLLOG SHPKNJP Tetovë
2. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale – (LSHMAAV), leja e transmetimit për televizion ose radio pushon të vlejë në bazë të ligjit, me marrjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) të nenit të cituar të ligjit, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesit nëse leja pushon të vlejë në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV-së.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 28-të mbajtur më 29.08.2023., në pajtim me Konkluzionin me nr. ark.02-3274/2 datë 29.08.2023., miratoi Vendimin PA1 nr. 08-260 datë 30.08.2023 . me çka i hoqi lejen Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISIONI POLLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.06.2016 ., përshkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga neni 80 paragrafi 5 i LSHMAV, respektivisht nuk e pagoi kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, nenit 23 paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1),

nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i zbardhur) Vendimi PA1 nr.08-260 datë 30.08.2023. për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TELEVISIONI POLLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.06.2016. dhe Konkluzioni me nr. ark. 02-3375/3 datë 06.09.2023 , Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të mbajtur më 06.09.2023 ., miratoi aktvendimin si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale ,
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.